

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani, kryetare, Erdogan Haxhibeqiri dhe Muhamet Rexha, anëtarë, në çështjen juridike të paditëses N.SH "P." me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson E.K., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës N.T.SH "M.", me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson H.S., avokat nga Prishtina, për shkak të borxhit, përkitazi me revizionin e të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.99/2014 datë 3.4.2015, në seancën e mbajtur më 9.2.2016, mori këtë

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pabazuar revizioni i të paditurës N.T.SH."M.", me seli në Prishtinë, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.99/2014 datë 3.4.2015, në pjesën që i referohet pagesës së borxhit dhe shpenzimeve të procedurës.

PRANOHET revizioni i të paditurës N.T.SH."M.", me seli në Prishtinë, përkitazi me normën e kamatës për pagesën e borxhit, gjykuar me aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulët, ashtu që, në këtë pjesë, **NDRYSHOHEN** aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.99/2014 datë 3.4.2015 dhe ai i Gjykatës Themelore Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, IV C.nr.390/2013, datë 12.2.2014, kurse e paditura N.T.SH "M.", me seli në Prishtinë, detyrohet që paditëses N.SH. "P.", me seli në Prishtinë, shumën e gjykuar të borxhit t'ia paguajë me kamatë, sipas normës të cilën e paguajnë bankat vendore për mjetet e afatizuara për një vit, pa destinim të caktuar, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë (16.06.2013), deri te pagesa definitive.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.99/2014 datë 3.4.2015, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurës dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, IV C.nr.390/2013, datë 12.2.2014, me pjesën I. të dispozitivit të të cilit detyrohet e paditura N.T.SH "M.", me seli në Prishtinë, që paditëses N. SH. "P.", me seli në Prishtinë, t'ia paguajë borxhin në shumë prej 44,575.60 €, me kamatë vjetore sipas normës prej 3.5% në vit, duke llogaritur nga data e paraqitjes së padisë, përkatësisht nga data 16.6.2013 deri te pagesa definitive, brenda afatit prej 7 ditësh, nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi. Me pjesën II të dispozitivit, e paditura është detyruar që paditëses t'ia paguajë shumën prej 640.00 €, në emër të

kompensimit të shpenzimeve të procedurës kontestimore, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, e paditura, përmes të autorizuarit të saj, ka paraqitur revizion brenda afatit ligjor, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që gjykata të marrë vendim adekuat me zbatim të drejtë të ligjit.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë sipas dispozitës së nenit 215 të LPK, ka gjetur:

Revizioni është pjesërisht i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se nuk është kontestues fakti se palët ndërgjyqëse kanë qenë në raporte juridiko-civile për prodhimin e emisioneve televizive për nevojat e të paditurës dhe për këtë kishin arritur dy marrëveshje: marrëveshjen përi bashkëpunim teknik të lidhur më dt. 25.12.2010 dhe marrëveshjen për bashkëpunim teknik të lidhur më dt. 2.1.2012. Kohëzgjatje e raportit të kontaktuar sipas këtyre dy marrëveshjeve ka qenë nga dt. 25.12.2010 deri në dt. 1.1.2013. Gjatë kohëzgjatjes së raportit afarist, paditësja kishte realizuar për të paditurën emisione sipas porosisë së kësaj të fundit. Sipas këtyre marrëveshjeve, paditësja ka pasur për obligim angazhimin e ekipit të saj për realizimin teknik në serialin televiziv “ O.”, për nevojat programore të RTK-ës. Me nenin 2 të marrëveshjeve është caktuar çmimi prej 1,960.00 € për secilin episod. Me nenin 5 të marrëveshjes është përcaktuar mënyra e pagesës; sipas kësaj dispozite, e paditura është dashur t’ia paguajë paditëses çmimin e caktuar për çdo episod të realizuar, pas konfirmimit të producentit se paditësja i ka përmbushur obligimet e saj. Është parashikuar që pagesa të bëhet në fillim të çdo muaji, nga dt. 1-4, për episodet që emitohen brenda muajit. Ashtu siç del nga shkresat e lëndës, për palët nuk është kontestues fakti se ndërgjyqësit kishin krijuar raporte juridiko-civile për prodhimin e emisioneve televizive për nevojat e së paditurës dhe as ekzistimi i borxhit të saj ndaj paditëses. Kontestuese është vlera reale e borxhit dhe koha e caktuar nga palët për përmbushjen e detyrimit.

Gjykata e shkallës së parë, nisur nga një gjendje e tillë e çështjes, ka angazhuar ekspertin e financave, V.V., për të konstatuar shumën e borxhit. Nga mendimi dhe konstatimi i ekspertes në fjalë, dhënë me shkrim në dt. 31.12.2013 dhe sqarimet plotësuese të bëra në seancën e datës 12.12.2014, është konstatuar se paditësja, gjatë periudhës kontestuese, i ka realizuar për të paditurën gjithsej 48 episode, për të cilat e paditura i ka paguar paditëses përmes transfereve bankare shumën prej 49.523,60 €, ndërsa i ka mbetur borxh edhe shumën prej 44,576.60 €. Gjykata e shkallës së parë, aktgjykimin e saj lidhur me shumën e borxhit e ka bazuar në mendimin dhe konstatimin e ekspertes V.V., prandaj, në mbështetje të dispozitës së neneve 15 dhe 17 të LMD, e aprovoi kërkesëpadinë e paditëses si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Gjykata e shkallës së dytë, në procedurë ankimore e ka pranuar si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik dhe konstatimin faktik të gjykatës së shkallës së parë, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të paditurës dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se gjykata e shkallës së dytë, në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë, i ka zbatuar drejt dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, duke aprovuar kërkesëpadinë e paditëses. Aktgjykimi i goditur nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat kjo Gjykatë i vëren sipas detyrës zyrtare.

Në mbështetje të gjendjes së përshkruar të çështjes, kjo Gjykatë gjeti se gjykata e shkallës së dytë ka dhënë argumente të mjaftueshme në mbështetje të konstatimit të saj, lidhur me aktgjykimin e goditur. Faktet që i ka vlerësuar gjykata e shkallës së dytë nuk vihen në dyshim nga thëniet në revizion, ndërsa provat e tjera të analizuara më hollësisht nga gjykata e shkallës së dytë e përforcojnë konstatimin e asaj të fundit në lidhje me zbatimin e të drejtës materiale me rastin e refuzimit të ankesës së të paditurës. Këtë qëndrim kjo Gjykatë e mori për arsye se, me provat e administruara, bindshëm dhe në mënyrë të sigurt janë vërtetuar faktet vendimtar se palët ndërgjyqëse kanë qenë në marrëdhënie kontraktuese nga data 25.12.2010 deri më datë 1.1.2013, dhe gjatë kësaj periudhe paditësja i ka kryer për të paditurën punët e kontraktuara dhe ka realizuar 48 episode televizive; për këtë periudhë është krijuar detyrimi i të paditurës për kompensimin e borxhit në shumë prej 94,099.20€, nga e cila e paditura ka paguar shumën prej 49,523.60 €, ndërsa i ka mbetur borxh shuma prej 44,576.60€. Prandaj, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, në rastin konkret të dy gjykatat kanë zbatuar drejt dispozitën e nenit 15,17 dhe nenit 262 të LMD, kur e kanë miratuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses.

Ndërkaq, për arsyet e dhëna nga ana e gjykatave të instancave më të ulëta dhe për arsyet e parashtruara nga kjo Gjykatë nga aspekti i zbatimit të së drejtës materiale, aktgjykimet e këtyre gjykatave janë të ligjshme.

Gjykata Supreme e Kosovës konstatoi se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilave u referohet revizioni, ngase dispozitivi i aktgjykimimit të saj është i qartë dhe nuk është në kundërtë me arsyetimin. Arsyetimi i aktgjykimimit të gjykatës së shkallës së parë përmban arsye të mjaftueshme për faktet relevante që kanë ndikuar në gjykimin e drejtë të kësaj çështjeje juridike. Parashtrimet në revizion lidhur me shkeljet e pretenduara të dispozitave të procedurës kontestimore, kjo Gjykatë i vlerësoi si të papranueshme për faktin se këto shkeljet nuk janë saktësuara dhe arsyetuar në kuptim të ligjit. Ndërkaq, gjykata e revizionit e shqyrton aktgjykimin e goditur brenda kufijve dhe shkaqeve të vëna në dukje në revizion (neni 215 i LPK).

Thëniet në revizion se gjykata e shkallës së parë nuk i ka vërtetuar tërësisht dhe saktësisht faktet kontestuese nga të cilat varet bazueshmëria e kërkesës lidhur me borxhin, ngase paditësja ka qenë dakord që pagesat të bëhen vetëm nga mjetet e realizuara që do i sillte emisioni i emituar në RTK dhe se këto mjete nuk janë paguar nga RTK-ja, ndër të tjera, edhe për shkak të ofrimit të shërbimeve jociësore nga ana e paditëses, kjo Gjykatë parashtrimet e tilla i vlerësoi si të papranueshme për faktin se e paditura nuk ka prezantuar prova relevante me të cilat do t'i argumentonte ato. Me dispozitën e nenit 7 të LPK, që gjen zbatim në rastin konkret, është përcaktuar detyrimi i palëve për

t'i paraqitur të gjitha faktet mbi të cilat i bazojnë kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat argumentohen këto fakte. Në këtë çështjen konkrete, paditësja ka argumentuar me prova se ka përmbushur pjesën e detyrimit të saj që del nga marrëveshjet e kontraktuara, ndërsa e paditura nuk ka arritur ta argumentojë faktin që ka të bëjë me pagimin e borxhit, kështu që për mosveprimet e veta, ajo nuk mund t'ia vesh gjykatës lëshimin e vet.

Gjykata Supreme, duke parë sipas detyrës zyrtare aplikimin e gabuar të së drejtës materiale, gjeti se kamata e aprovuar mbi shumat e gjykuara është zbatuar në mënyrë jo të drejtë sipas dispozitës së nenit 277 të LMD, ngase kjo kamatë nuk është caktuar në përputhje me këtë dispozitë ligjore, pasi që kamata e pranuar me normën prej 3.5%, nuk është e thënë të jetë e njëjtë në të gjitha bankat vendore. Andaj, duke u nisur nga fakti se për sa i përket kamatës së aprovuar aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, i njëjti aktgjykim në këtë pjesë u ndryshua në bazë të dispozitës së nenit 224 par. 1 të LPK.

Nga sa u tha më sipër dhe me zbatimin e nenit 222, lidhur me nenin 224.1 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTIN
E.Rev.nr.8/2016 datë 9.2.2016

Kryetare e kolegjit,
Gyltene Sylejmani